



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.182/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevi dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), për shkak të vendosjes së posterit në shtylla elektrike, të kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ndërsa subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 500.00 (pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datën 08.10.2017 në rrugën “Saraçet” në Prizren, monitoruesit e tyre kanë hasur poster të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik KDTP të ngjitur në shtylla elektrike . Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik KDTP, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 12.10.2017, subjekti politik KDTP, thekson se pas pranimit të ankesës nr. ZL.Anr.81/2017 ka ndërruar masat paraprake për heqjen e posterave, ashtu që me datë 10.10.2017 nuk i ka pasur posterët në vendet e përmendura në ankesë. Për të mbështetur pretendimet ankimore, ka bashkangjitur fotografi ku nuk shihen posterët e vendosur në shtylla elektrike.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik KDTP është vendosur në shtylla elektrike gjegjësisht në hapsira dhe në rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik KDTP, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterit i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik KDTP, është vendosur në hapsira dhe në rrugë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik KDTP, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterit i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik KDTP është vendosur në shtylla elektrike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL. Anr.182/2017 më datën 12.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Ferizullah Rexhepi

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.